



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1.1 i Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, merr këtë

**VENDIM**  
**PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS,**  
**INSTITUTIT NDËRKOMBËTAR PËR INTELIGJENCË TË JASHTËZAKONSHME**  
**“ATOMI”**

- I. Miratohet Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Institutit ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme “Atomi”.
- II. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është:

Kati i sipërm i SHML “Gjimnazi Matematikor” me sipërfaqe prej 1474.18 m<sup>2</sup>, si dhe hapësirat e tjera shtesë të përbashkëta (oborri, bufeja, salla dhe terrenet sportive), me objektet përcjellëse, të vendosura në parcelën kadastrale nr. 2892-5, ZK Prishtinë, pasuri shoqërore e Komunës së Prishtinës.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën II të këtij vendimi, është nxitja e zhvillimit të arsimit dhe shkencën në komunën e Prishtinës, përkatësisht në Republikën e Kosovës.
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është afatshkurtër, në periudhën prej 10 vjetëve.
- V. Prona e paluajtshme e cekur në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të objektit do të caktohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit.

VII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01. nr. 035-121616 , më 19.05.2016



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Halim Halimi, jur. i dipl.